

Kisha e Shën Sofisë



Kisha e Shën Sofisë – Ἀγία Σοφία; në shqip e përkthyer si Kisha e “Diturisë Hyjnore” është ndërtuar në vitin 537 në qytetin e Kostandinopojës me urdhër të Perandorit Justinian I. Arkitektët që punuan për ndërtimin e saj ishin Isidori i Miletit dhe Anthemi i Trales.

Ky monument është një prej shembujve më të arrirë në arkitekturën Bizantine dhe shënoi revolucionin më të madh në arkitekturën e Krishterë dhe për më tepër se 1000 vite mbajti vendin si Kisha më e madhe në të gjithë botën.

Shën Sofia ishte një shembull arkitekturor jo vetëm për ndërtesat e Krishtera por edhe për arkitekturën Otomane të mëvonshme ku kupola dhe harqet u kopjuan në mjaft xhami të vogla e të mëdha nëpër të gjithë Perandorinë Osmane .

Pas pushtimit të Kostandinopojës nga Osmanët në vitin 1453 Kisha u shndërrua në xhami, duke shërbyer si një xhami perandorake për Sulltanët Osmanë.

Mbeti si e tillë deri në vitet 1930’ kur Mustafa Kemal Atatürk urdhëroi që Shën Sofia të kthehej në muze. Një vendim i tillë u dha për të ruajtur trashëgiminë historike të

monumentit si një simbol i paqes ndërmjet besimeve.

Vendimi i qeverisë Turke në 10 korrik 2020 riktheu pas dekretin e presidentit Atatürk, duke cenuar statusin aktual të Shën Sofisë dhe duke vënë në rrezik vlerat kulturore dhe historike të një monumenti që shkon përtej kufijve të Turqisë së sotme.

Përgatiti: Ledio Karaj

— facebook.com/LidhjaRinoreOrthodhokseElbasan